ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PODUJEVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **615-21-7143-5-2-1**

Sa i përket tenderit për:

Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik Penuhë Gllamnik Katunishtë Bellopojë Konushec Lluga Sfeqel Siboc dhe Godishnjakë

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

____ "ETM Group SH.P.K." ____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____Rr. "Hamdi Grajqevci" Nr 11 _____
(Adresa)

_____ Fushë Kosovë _____ **_____12000_____**
(Vendi) *(Kodi postar)*

_____049555686_____ **_____**
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

_____Granit Kutllovci_____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____ info@etmgroup-ks.com_____
(Adresa elektronike)

SH.P.K.
ETM Group
Fushë Kosovë

_____29.11.2021_____ **_____**
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ky aktivitet i prokurimit ka te beje me tenderin: "**Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik Penuhë Gllamnik Katunishtë Bellopojë Konushec Lluga Sfeqel Siboc dhe Godishnjakë**".
Njoftimi për kontratë është bërë me datën 01.10.2021 dhe hapja publike është bërë me datën 21.10.2021.
Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar më 17.11.2021.

Të pakënaqur me këtë vendim iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim në datën 17.11.2021.

Përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datë 19.11.2021 me të cilën nuk pajtohemi andaj në afat të rregullte kohorë po iu drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

Kriteri i vlerësimit ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja publike është bërë më datën 17.11.2021. Gjate hapjes publike nuk u evidentua ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar më 17.11.2021. Të pakënaqur me këtë vendim iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim me datën 17.11.2021.

Përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim si refuzim e kemi pranuar me datë 19.11.2021 me të cilën nuk pajtohemi andaj në afat të rregullte kohorë po iu drejtohemi OSHP-së me këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. **AK ka shkelur Nenin 59 të LPP-së Nr. 04/L-042,**
2. **AK ka shkelur Nenin 60 të LPP-së Nr. 04/L-042,**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gabimisht ka aplikuar paragrafin 3 të këtij nenin për gjoja ne paskemi bërë gabim aritmetikorë. Me që pretendimin tonë lidhur me librezat e mjeteve të punës AK e ka pranuar si të bazuar, ne po e paraqesim vetëm pretendimin lidhur me “gabimin aritmetikorë” siç pandehë AK.

AK ka vlerësuar gabim lidhur me këtë çështje sepse ne e kemi plotësuar listën e çmimeve në përputhje me kërkesat e listës e gjithashtu edhe tek formulari i tenderit kemi vendosur çmimet ashtu siç kërkoheshin në e-prokurim. Kjo mund të shihet qartë nga procesverbali i hapjes publike ndërsa përmirësimi i AK-së duke ia shtuar çmimit tonë përfundimtarë edhe një here vlerën e TVSH-së prej 18% është shumë e pakuptimtë dhe tendencioze. Se si ishte plotësuar lista e çmimeve dhe si ishte paraqitur çmimi tek e-prokurimi mundeni ta vëreni nga lista jonë e çmimeve dhe nga procesverbali i hapjes publike. Ne po e paraqesim për qëllime sqarimi edhe këtu:

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në disa fshatra - Penuhë L.Dedia , Gllamnik L.Llapashtica ,Selmani ; Katunishtë Lagjet Kastrati , Bryma , 27 Dhjetori , Lusria ; Bellopojë L.Maloku ; Konushec Rruga Kryesore (nga magjistralja deri te trafo) ; Lluga (Mulla Ahmet Çunaku vazhdim) ; Sfeqël (Rr.Mehmet Mehana) ; Siboc ; Godishnjak ; etj.

	PARAMASA DHE PARALLOGARIA				
Nr.	**Përshkrimi i Produkteve**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi**	**Totali**
1	Trupi ndriçues - 55W Furnizimi dhe instalimi i llambës kompakte të LED teknologjisë. Llamba nga aspekti i dizajnit dhe kualitetit duhet ti plotësoj standardet Evropiane, CE, ENEC, Directive 2014/30/EC, 2014/35/EC, 2009/125/EC 1194/2012/EU, 2011/65/EC, EN 60598, EN 62471, EN 55015, EN 61000, EN 62493, EN 61547. dhe të ketë: Trupi ndriçues - Llamba komplet kompakte e LED teknollogjis • Mbrojtje mekanike; IP66, IK09 • Qëndrueshmëri pune: ≥L90B10 100 000 (h) • Efikasitet të ndriçueshmërisë: ≥110 lm/W • Temperaturë të ngjyrës: ≤ 4000K • Tension pune: 220...270 V (50Hz) • Temperaturë pune: (-40 ... +35)°C • ULOR=0 Kushtet e ndriçimit: • Klasa e mbrojtjes: I • Llamba duhet të plotësojë klasën e ndriçimit M5 • Lartësia e instalimit të llambës: 6.7m • Buxheti "Lloji 1"	copë	520	22.00	11,440 €
2	Furnizimi dhe montimi i kabllos bystek 4x16 mm² për ndriçim publik	m'	5124	1.40	7,174 €
3	Furnizimi dhe montimi i shtërngueseve të kabllit bystek 4x 16 mm²	copë	214	1.20	257 €
4	Furnizimi dhe montimi i kabllos bystek 2x16 mm² për ndriçim publik	m'	16580	0.80	13,264 €
5	Furnizimi dhe montimi i shtërngueseve të kabllit bystek 2x 16 mm²	copë	726	0.80	581 €
	⋮				
15	Furnizimi dhe montimi i shtyllave te betonit H-9m, bartese	copë	64	160.00	10,240 €
16	Betonimi i shtyllave te betonit. Betonimi realizohet duke ndertuar nje pllake katrore me dimensione 80x80x50cm pasi te jet vendosur shtylla, te jete vendosur zhavori dhe ngjeshja e tij para betonimit	m³	20.5	50.00	1,024 €
17	Furnizimi dhe montimi i kabllit 3x2.5mm² PGP për lidhje të trupit ndriçues me kabllin e furnizimit , mesatarisht 1 m për një trup ndriçues	m'	520	0.70	364 €
18	Furnizimi dhe montimi i klemeve izolues për kyçje të trupave ndriçues në kabllin e furnizimit. Klemet për kabllo 4 x 16 mm2,(1.5-35)mm² dhe 2 x 16mm2 (1.5-35) mm²	copë	1040	1.20	1,248 €
				Gjithsej	57,684.41 €
				tvsh 18%	11,508.79 €
				Totali	**69,193.20 €**

Nga lista jonë e çmimeve shihet qartë se AK nuk e ka përcaktuar askund se çmimet për njësi duhet të vendosen pa TVSH. Me vet faktin se në fillim të tabelës në kolonën e fundit ceket se kërkohet të vendoset totali i çmimit për njësi dhe në fund të tabelës prapë kërkohet totali i çmimeve njësi atëherë nënkupton se çmimet njësi do duhej vendoseshin me TVSH. Tabela nuk është e përpiluar si duhet andaj ne kemi qenë të detyruar

ta plotësojmë ashtu sipas kërkesave të sajë. Kur në tek çmimi njësi nuk është përcaktuar se a duhet të vendoset çmimi me apo pa TVSH, ndërlidhja në mes të dy totaleve siç shihen në tabelë, detyrimisht të bënë obligator të vendosësh çmimin njësi me TVSH. Për qëllime të mundësisë së plotësimit të tabelave në e-prokurim ne kemi nxjerrë edhe TVSH-në dhe çmimin pa TVSH që e kemi vendosur në tabelë. Këtu nuk ka asnjë hamendesim se ne kemi vendosur çmim pa TVSH dhe AK pa asnjë bazë ligjore të na kalkulon edhe një here TVSH-në në vend se të kërkoj sqarim nëse ka pas diçka të paqartë. Këtu nuk ka asnjë paqartësi sepse tek tabela e procesverbalit të hapjes e ka pasur shumë çartë të potencuar çmimin me dhe pa TVSH.

Ne nuk arrijmë të kuptojmë se pse AK pretendon se kemi bërë gabim aritmetikorë kur i ka në tabelë të vendosura të gjitha të dhënat saktë ashtu siç i kishte kërkuar e të cilat përshtaten saktë me çmimin tenderues të vendosur në formularin e tenderit dhe në procesverbalin e hapjes publike. Ja si duket procesverbali i hapjes publike dhe formulari i tenderit i krijuar nga sistemi:

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

ri i prokurimit urement number nabavke:	615-21-7143-5-2-1	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik Penuhë Gllamnik Katunishtë Bellopojë Konushec Lluga Sfeqel Siboc dhe Godishnjakë
ri i brendshëm nal No ni broj	61521128521		

lëshimit f issue izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
.2021	21.10.2021, 13:00:00	21.10.2021, 13:00:00	Komuna e Podujevës kati 0 zyra nr.7	7

	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena

	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
			Godishnjakë				
	TONI INGJINJERING, Gllogoc-Negrofc, 13050, NEGROVC	Nr.27.-KOMUNA E PODUJEVES	Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik Penuhë Gllamnik Katunishtë Bellopojë Konushec Lluga Sfeqel Siboc dhe Godishnjakë	PO	77415,60	91350,41	JO
	" ETM Group " SH.P.K., Hamdi Grajqevci, Nr.11, -, FUSHË KOSOVË	2110/2021	Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik Penuhë Gllamnik Katunishtë Bellopojë Konushec Lluga Sfeqel Siboc dhe Godishnjakë	PO	58638,31	69193,20	JO
	Grup i Operatorëve Ekonomik ART - NET SH.P.K.; Pi Engineering L.L.C. Rr. Nëna Terezë,	NDRIQIMI PODUJEVE	Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik Penuhë Gllamnik	PO	71115,16	83915,89	JO

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

3. Çmimi total i tenderit është:

69 193,20 EUR

Dhe në fjalë [*shëno çmimin e tenderit në fjalë* ***Euro***]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 60 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

Pra po shihet qartë se gjithçka është paraqitur në rregull dhe AK ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 59.4 të LPP-së duke na kontestuar mënyrën e plotësimit të dosjes së tenderit dhe duke e aplikuar gabimisht nenin 59.3 të LPP-së për gjoja gabim aritmetikorë.
Sipas rregullave lidhur me gabimet aritmetikore, kur kemi mospërputhje në mes të çmimit të tenderuar në e-prokurim me çmimin e vendosur në listën e çmimeve duhet aplikuar sqarimi dhe gjetja e gabimit të kalkulimit. Këtu nuk kemi gabimin e tillë sepse çmimi përfundimtarë i listës së çmimeve është saktë i njëjtë sikur ai tek e-prokurimi dhe procesverbali i hapjes publike.
Në rastet kur çmimet për njësi nuk përputhem me totalin, prapë korrigjohen dhe merret për bazë çmimi njësi. Tek rasti jonë çmimi për njësi përputhet saktë me totalin e çmimeve të sasisë së njësisë si dhe me totalin e të gjithë artikujve që është vendosur në fund të tabelës. Çmimet nuk janë kërkuar askund pa TVSH andaj ne i kemi vendosur me TVSH sepse vet tabela e ka kërkuar një gjë të tillë. Në tabelë kemi kalkuluar TVSH-në dhe çmimin e tërësishëm pa TVSH me qëllim të mundësisë së aplikimit në e-prokurim tek tabela ku kërkohet vendosja e çmimit pa TVSH, me TVSH dhe TVSH e ndarë.

nulari i dorëzimit të tenderit"	Çmimi	58 638,31
firmimit të tenderit	Çmimi me TVSh	69 193,20
	Vlera e TVSH	10 554,89

I vetmi gabim që ka ndodhur është ai se TVSH tek formulari i tenderit është paraqitur në rregull ku çmimi pa TVSH është 58,638.31€ ndërsa tek lista e çmimit nuk përputhet saktë dhe është paraqitur 57,684.41€. Kjo ka ardhur si aplikim i gabuar i normës së TVSH-së
Sipas interpretimit nr 46 tek pyetjet e shpeshta AK duhet ta përmirësoj gabimin në TVSH pa pasur nevojë sqarime shtese nga OE. Ja interpretimi:

46. Si të veprohet në rastet kur një Operator Ekonomik normën e TVSH-ës të përcaktuar me ligjin mbi TVSH-ën, për një apo më shumë artikuj në ofertën e tij e vendos gabimisht pra e vendos jo në bazë të normës së përcaktuar me Ligjin mbi TVSH-ën?

Në rast se një Operator Ekonomik ofron një çmim ku % (përqindja) e TVSH-ës është e gabuar (më e lartë apo më e ultë se norma e aplikueshme e TVSH-ës) Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë

Përpos kësaj nga KRPP kemi edhe interpretimin se gabimi në normën e TVSH-së nuk konsiderohet gabim aritmetikor dhe nuk mund të aplikohet neni 59.3 të LPP-së. Shiko interpretimin:

From: Info Krpp [mailto:Info.Krpp@rks-gov.net]
Sent: Friday, September 13, 2019 11:19 AM
To: [redacted]
Subject: Re: Nje pyetje urgjente - Sqarim mbi gabimet ne normen e TVSH ne nje oferte ekonomike

E nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në të dhënat shkresës suaj, KRPP, ofron interpretimin ligjor si në vijim:

Bazuar ne pyeyjen tuaj, Autoriteti Kontraktues mund ta korrigjoj normën e TVSH-ës (si psh: nëse OE në vende që ta ofroj normën e TVSH-ës , 8% ose 18% për artikuj gabimisht) . Përgjigjëjen e njëjtë KRPP e ka publikuar në E-prokurimi "Informacione" te pyetjet e shpeshta , Pergjegjëja me nr.46.

Gabimet ne llogaritje te TVSH nuk trajtohen gabime aritmetikore .

Ju pershendesim,
Abdyl Limani-ekspert i prokurimit
D.Rregullave ne KRPP

****

Vërejtje: *Interpretimi i dhënë nga KRPP, i referohet vetëm pyetjes së parashtruar nga ana juaj dhe assesi nuk i dedikohet aktivitetit të prokurimit.*

Pra bazuar në krejt këtë që sqaruar më lartë del që veprimi i AK-së duke shtuar normën e TVSH-së në çmimin përfundimtarë del të jetë shumë absurde dhe komplet në shpërputhje me normat ligjore të parapara për këtë qëllim. Shiko si e ka kalkuluar AK normën e TVSH-së mbi çmimin tonë përfundimtar:

	zhavori dhe ngjeshja e tij para betonimit	m'	20.5	50.00	1,024 €
17	Furnizimi dhe montimi i kabllit 3x2.5mm² PGP për lidhje të trupit ndriçues me kabllin e furnizimit , mesatarisht 1 m për një trup ndriçues	m'	520	0.70	364 €
18	Furnizimi dhe montimi i klemeve izolues për kyçje të trupave ndriçues në kabllin e furnizimit. Klemet për kabllo 4 x 16 mm2,(1.5-35)mm² dhe 2 x 16mm2 (1.5-35) mm²	copë	1040	1.20	1,248 €
				Gjithsej	57,684.41 €
				tvsh 18%	11,508.79 €
				Totali	**69,193.20 €**

TVSH - 12,454,77

81,647,97

Kjo është shumë e pakuptimet, antiligjore dhe shumë tendencioze ku vetëm një mos njohës i Ligjit dhe rregullave të prokurimit do ta bënte një veprim të tillë. Me që në tabelë qartë figuron çmimi pa TVSH, TVSH-ja dhe Çmimi total me TVSH i cili përputhet plotësisht me totalin e çmimeve njësi të vendosura sipas sasisë tek kolona e fundit e tabelës, aplikimi i dyfishtë i normës së TVSH është plotësisht gabim dhe i pakuptimet. Bazuar në krejt këtë që e sqaruam më lartë shihet dhe lehtë konstatohet se AK përkatësisht Komisioni i Vlerësimit së bashku me Zyrtarin Kryesor të Prokurimit kanë shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së si pasoj e mos vlerësimit saktë sipas nenit 59 të LPP-së. Mos aplikimi i drejtë i nenit 59 e ka shtyrë AK drejt veprimit të gabuar ku ka shpërblyer me kontratë një OE që posedon çmimin afro 10% ose për **8,838.31€** më të lartë se ne. Kjo konsiderohet shkelje e plotë e kriterit të vlerësimit Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të Ulët dhe njëherit edhe shkelje e plotë e nenit 60 të LPP-së.

Pas gjithë këtyre sqarimeve, dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdese ankesën tonë dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar duke marrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE **"ETM Group SH.P.K."** lidhur me tenderin "**Zgjerimi i rrjetit të ndriqimit publik Penuhë Gllamnik Katunishtë Bellopojë Konushec Lluga Sfeqel Siboc dhe Godishnjakë**" i iniciuar nga **KOMUNA E PODUJEVËS.**

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - **KOMUNA E PODUJEVËS** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim.**

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar ne kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së e që realisht më pas do duhej që Fitues të shpallej OE **"ETM Group SH.P.K.".**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë në aspektin teknik. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, me një përvojë të madhe në këtë fushë të furnizimeve.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 1 B05 Njoftim per Kontrat
- 2 Template per Dosja e Tenderit SHQIP
- 3 Zgjerimi i rrjetit te ndriqimit publik ne disa fshatra
- 4 Procesverali i hapjes
- 5 Njoftim mi vendimin e AK
- 6 Kerkese per Rishqyrtim
- 7 Vendim pezullimi - ndriqim publik
- 8 Vendim mbi kerkesen per rishqyrtim - ETM Group
- 9 Interpretimi i KRPP per Normen e TVSH-se
- Oferta e ETM Group

Vërejtje: *Të gjitha pretendimet tona mbështeten me fakte që i gjeni të bashkangjitura kësaj kërkesë por e dhe në dokumentacionin e AK*